



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Stilistikë e Gjuhës Angleze (B)

Ngarkesa: 4 ECTS, 15 orë leksione, 25 orë seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Angleze

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuritë themelore teorike të stilistikës së gjuhës angleze. Të zhvillojë ndërgjegjësimin gjuhësor dhe stilistik përmes analizës së teksteve të shkruara dhe të folura. Të nxisë përdorimin e gjuhës si mjet shprehës dhe interpretues në kontekste akademike dhe profesionale.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të ndihmojë studentët të analizojnë regjistra gjuhësorë, stilet dhe zhanret në tekste të ndryshme.
2. Të aftësojë studentët për të shkruar tekste sipas regjistrit dhe kontekstit, si dhe të përdorin teknikën stilistike në mënyrë krijuese.
3. Të zhvillojë aftësitë kërkimore dhe interpretuese, përmes ushtrimeve praktike në klasë dhe në detyrat e pavarura.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë të aftë:

1. Të kuptojnë analizën stilistikore të një teksti të caktuar;
2. Të kryejnë analizën stilistikore të një teksti të caktuar;
3. Të bëjnë krahasime të mjeteve stilistikore të përdorura në tekste të natyrave të ndryshme;
4. Të jenë në gjendje të dallojë llojet e teksteve të ndryshme;
5. Të jenë më analitikë, dhe të lexojnë përtej rreshtave.